



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Gërlica-Company" Sh.P.K. të datës 07.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 02.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve IV LLOTE" me nr. të prokurimit 616-23-269-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Gërlica-Company" Sh.P.K. e datës 07.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 02.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve IV LLOTE" me nr. të prokurimit 616-23-269-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Gërlica-Company" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Gërlica-Company" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 07.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 02.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve IV LLOTE" me nr. të prokurimit 616-23-269-5-1-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) - *“Nga analiza e përlogaritjeve, shihet që ne kemi 77.73 poena dhe është dashur të shpallemi fitues të kontratës për Lot III, prandaj kërkojmë nga ju që të analizoni edhe njëherë këtë lëndë dhe të bëni përlogaritjet e sakta”.*

Pretendimi i dytë (II) - *“Gjithashtu ju njoftojmë se OE Kopshti dhe Kema Company janë të papërgjegjshme... Po ashtu pajtohem me arsyen e eliminimit të OE Harst Shpk”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60 dhe 72 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 13.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e parë (I) - fillimisht duhet cekur se të gjithë tenderët e ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit janë vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar nga një komision vlerësues profesionist, të pavarur, objektiv dhe në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi. Bazuar në raportin që ka nxjerrë ky komision i vlerësimit, parashtruesi është vlerësuar me 57.07 pikë totale, bazuar në të gjitha kriteret e dosjes së tenderit ku kriter i dhënies ka qenë tenderi ekonomikisht më i favorshëm. Në anën tjetër parashtruesi pretendon se është dashur të vlerësohet me 77.73 poena mirëpo nuk ka treguar si ka ardhur deri të kjo përlogaritje dhe aq më tepër nuk ka shpjeguar se në cilën pjesë të raportit ka gabuar komisioni vlerësues sikurse pretendon parashtruesi. Me fjalë të tjera parashtruesi fare nuk e ka kontestuar vlerësimin e komisionit vlerësues mirëpo thjeshtë i ka bërë një vlerësim vetvetes dhe këtë e ka paraqitur më tutje si pretendim ankimor në kërkesën për rishqyrtim. Kuptohet se ky pretendim si tillë nuk mund të jetë i qëndrueshëm përderisa parashtruesi nuk ka prezantuar asnjë argument, provë apo dëshmi të vetme për të mbështetur pretendimin e tij. Në cilindo rast çështja e vlerësimit të ofertave është kompetencë ekskluzive e komisionit vlerësues i cili në rastin konkret është jo vetëm profesional por edhe objektiv dhe plotësisht i pavarur sipas LPP dhe RRPP. Përndryshe përbërja por as puna e komisioni nuk kontestohet as nga vet parashtruesi. Prandaj pretendimi i parë është i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) - duhet theksuar që parashtruesi në vend se të parashtroj pretendim ankimor ka shprehur pajtimin e tij për njoftimin mbi vendimin e AK të cilin e ka goditur me këtë kërkesë për rishqyrtim. Rrjedhimisht pretendimi i dytë i parashtruesi në fakt nuk përbën fare pretendim ankimor pasi që manifeston një gjendje faktike që nuk është as konstestuese mes palëve dhe as relevante në kuptimin juridik të fjalë. Rrjedhimisht edhe pretendimi i dytë i parashtruesit është i pabazuar në tërësi.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 13.06.2023



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.